



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E PËRGJITHSHME
PROKURORI I PËRGJITHSHËM

Nr. 1108 | prot.
| 2

Tiranë më, 29.07.2022

UDHËZIM I PËRGJITHSHËM

Nr. 02, datë 29.07.2022

PËR

REKOMANDIMET PRIORITARE NË LUFTËN KUNDËR KRIMINALITETIT PËR VITIN 2022 NË PROKURORITË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM

Në mbështetje, të neneve 148 dhe 148/b shkronja “b” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 38 pika 2 shkronjat “b” e “f”, 42 shkronja “a”, “g”, “l” 43, 45 pika 1, 46 pikat 1, 3 shkronja “c”, 48, 103 e vijues të ligjit nr.97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 6 pika 32 e ligjit nr.8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, nenit 5, 7 e vijues të ligjit nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore”, i ndryshuar, dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.304, datë 11.05.2022 “Për miratimin e rekondimeve prioritare në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2022”¹

UDHËZON:

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i këtij udhëzimi të përgjithshëm është unifikimi i ndjekjes dhe zbatimi i rekondimeve prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit² për vitin

¹ Shih, Fletorja Zyrtare, Viti: 2022 – Numri: 74, publikuar me 18 maj 2022.

² Shih, neni 103 “Marrëdhënet me Këshillin e Ministrave” të ligjit nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i cili në pikën 1 parashikon: “I.Këshilli i Ministrave, jo më vonë se data 31 mars e çdo viti,

2022 (në vijim “rekomandime prioritare”) në kompetencë lëndore të prokurorive me juridikcion të përgjithshëm, pa cënuar pavarësinë e prokurorisë³ si organ që garanton mbarëvajtjen, kontrollin e veprimtarisë së saj dhe respekton pavarësinë e brendshme të prokurorëve për hetimin dhe ndjekjen penale sipas ligjit.

**Neni 2
Objekti**

1. Objekt i këtij udhëzimi të përgjithshëm janë:

a) Përcaktimi i masave administrative që duhet të merren për realizimin e përparësive që sigurojnë zbatimin e rekomandimeve prioritare në kompetencë të prokurorive me juridikcion të përgjithshëm.

b) Përcaktimi i masave procedurale lidhur me mënyrën e vlerësimit, ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve prioritare që çojnë në rritjen e eficencës në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2022 sipas prioriteteve të rekomanduara dhe kompetencës lëndore në ushtrimin e funksioneve nga drejtuesit e prokurorive dhe prokurorët.

c) Përcaktimi i mënyrës dhe formave të komunikimit ndërmjet oficerëve të policisë gjyqësore dhe prokurorëve me drejtuesit e prokurorive sipas niveleve dhe strukturat përkatëse⁴ në Prokurorinë e Përgjithshme, për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve prioritare dhe udhëzimeve të nxjerra në zbatim të tyre.

2. Ky udhëzim i përgjithshëm nuk trajton ndjekjen/zbatimin e masave të rekomandimeve prioritare për të cilat janë miratuar dhe mbikëqyret, zbatimi i udhëzimeve të përgjithshme specifike në fuqi.

**Neni 3
Përkufizime**

Në këtë udhëzim, termat/emërtimet kanë kuptimin, si më poshtë:

1. “Rekomandime për zbatimin e politikës në luftën kundër krimít” janë rekomandime të nxjerra nga autoriteti legjislativ ose ekzekutiv për zbatimin e politikës në luftën kundër krimít si një nga detyrat kryesore të prokurorit publik sipas standardeve evropiane⁵.

miraton dhe i përcjell Prokurorit të Përgjithshëm rekomandimet prioritare që duhen ndjekur për vitin në vazhdim në luftën kundër kriminalitetit

³ Neni 148 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i cili në pikën 2 parashikon: “*2. Prokuroria është organ i pavarur që garanton mbarëvajtjen, kontrollin e veprimtarive të saj dhe respekton pavarësinë e brendshme të prokurorëve për hetimin dhe ndjekjen penale sipas ligjit*”

⁴ Sektori i Monitorimit pranë Drejtorisë së Kordinimit Institucional dhe/ose struktura të tjera në Prokurorinë e Përgjithshme që mbikëqyrin zbatimin e rekomandimeve prioritare në drejtimet kryesore përkatse.

⁵ Shih, Rekomandimet e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës nr.19/2000, datë 6 tetor 2000 “*Për rolin e prokurorit publik në sistemin e drejtësisë penale*”, tek pjesa “Komentet e Rekomandimeve Individuale” nënpjesa “Funksionet e prokurorit publik, pika 3 parashikon: “*Në disa sisteme të drejtësisë penale, prokurorët publikë, gjithashtu: -zbatojnë politikën penale kombëtare ndërsa e adoptojnë atë, aty ku është e përshtatshme, me rrethanat lokale dhe rajonale;*”, duke vijuar komenti:

“*Zbatimi i politikës kundër krimít siç përcaktohet nga autoriteti legjislativ ose ekzekutiv është një nga detyrat kryesore të prokurorit publik në shumë vendë. Përshtatja e politikës kombëtare me realitetet rajonale dhe lokale nuk nënkuption lirinë e prokurorëve publikë për t'u larguar nga priorititetet e përcaktuara në strategjinë qendrore ose për të rrezikuar zbatimin e saj të vazdueshëm. Përkundrazi: përshtatja ndaj kushteve rajonale dhe lokale është një kusht paraprak nëse këto përparësi zbatohen siç duhet.*”

2. “Rekomandime prioritare”⁶ janë rekomandimet prioritare të miratuara nga Këshilli i Ministrave për luftën kundër kriminalitetit që i përcillen Prokurorit të Përgjithshëm nëpërmjet Ministrit të Drejtësisë, mbi kërkesën e të cilit, jo më pak se dy herë në vit, informohet mbi zbatimin e tyre.

3. “Drejtime të rekomanduara”⁷ janë drejtimet kryesore të rekomandimeve prioritare për vitin 2022: -garantimi i pavarësissë dhe përgjegjshmërisë së prokurorit, -lufta kundër korruptionit, -lufta kundër krimít të organizuar, -respektimi i të drejtave të njeriut, dhe -bashkëpunimi ndërinstitucional.

4. “Veprat penale prioritare të rekomanduara”⁸ janë veprat penale dhe/ose grupveprat penale të përfshira në drejtimet përkatse të rekomanduara dhe/ose ato të cituara në rekomandimet prioritare dhe/ose në këtë udhëzim.

KREU II MASAT ADMINISTRATIVE

Neni 4

Masat administrative në Prokurorinë e Përgjithshme

1. Drejtoria e Koordinimit Institucional në Prokurorinë e Përgjithshme, brenda 15 ditëve nga mbërritja e rekomandimeve prioritare, përgatit planin e veprimit për vlerësimin dhe ndjekjen e masave dhe/ose aktiviteteve në afatet e përcaktuara, për zbatimin e rekomandimeve prioritare në prokuroritë e juridikacionit të përgjithshëm dhe në strukturat përkatëse të Prokurorisë së Përgjithshme.

2. Plani i veprimit miratohet nga Prokurori i Përgjithshëm, pas diskutimit dhe térheqjes së mendimit në mbledhjen e prokurorëve të Prokurorisë së Përgjithshme⁹, plan i cili, bashkë me rekomandimet prioritare, i dërgohet drejtuesve të prokurorive të juridikacionit të përgjithshëm.

3. Marrjen e masave nga strukturat përkatëse, si për rishikimin dhe mirëfunksionimin e sistemit elektronik të ndarjes së çështjeve në prokurori, ashtu dhe për mbikëqyrjen teknike dhe administrative nëpërmjet kërkesave për informacion lidhur me mënyrën e disponimit për hedhjen e shortit elektronik nëpërmjet sistemit CAMS në të gjitha fazat e procedimit penal, si dhe kontrolli i vazhdueshëm mbi hedhjen dhe administrimin e këtyre të dhënave.

4. Vijimin e rritjes së mëtejshme të bashkëpunimit nga struktura përkatëse me agjencitë ligjzbatusese rajonale dhe ndërkombëtare në funksion të efektivitetit të hetimeve për veprat penale prioritare të rekomanduara, veçanërisht ato që lidhen me korruptionin, trafikimin e narkotikëve,

⁶ Shih, nenin 103 “Marrëdhëniet me Këshillin e Ministrave” të ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe nenin 6 pika, 32 e ligjit nr.8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar;

⁷ Shih, Rekomandimet Prioritare n luftn kundr kriminalitetit pr vitin 2022, të miratuara me vendimin nr.304, dat 11.05.2022 e Kshillit t Ministrave;

⁸ Shih, nenin 103 “Marrëdhëniet me Këshillin e Ministrave” të ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe nenin 6 pika, 32 e ligjit nr.8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar;

⁹ Shih, nenin 54 shkronja “ë” e ligjit nr.97/2016.

pastrimit të parave, trafikimin e qenieve njerëzore, veprat penale kundër mjedisit, krimet kibernetike etj.

5. Mbikëqyrja e përditësimit dhe plotëshmërisë së të dhënave për procedimet/çështjet e pastrimit të parave dhe procedimeve pasurore nëpërmjet sistemit elektronik e-tracking PRESTO si për vënien në eficensë sa më të plotë, ashtu dhe për përfimin e të dhënave statistikore, sipas një baze të të dhënave të qëndrueshme e të besueshme, për reforma të mëtejshme, për të rritur numrin e procedimeve penale të dërguara për gjykim dhe të dënimive për veprat penale prioritare dhe sipas tipologjive të rekomanduara.

6. Përmirësimi i koordinimit institucional dhe ndërinstitucional me institucionet dhe agjencitë e përfshira në lidhje me të dhënat statistikore prioritare të rekomanduara, në zbatim të rekomandimeve të BE-së në kuadrin e integrimit european të vendit.

7. Marrjen e masave për rritjen më tej të eficencës në bashkëpunimin ndërinstitucional për përbushjen e rekomandimeve të Moneyval-it, në kuadrin e mbikëqyrjes/monitorimit të zbatimit të udhëzimit të përgjithshëm nr.10/2020 “Për masat administrative dhe procedurale për rritjen e efektivitetit në luftën kundër pastrimit të parave e kimeve financiare dhe financimin e terrorizmit, dhe në hetimet pasurore në prokuroritë me juridikzion të përgjithshëm” si për të rritur më tej numrin e procedimeve dhe të pandehurve të dërguar për gjykim, dhe të dënuarve për veprat penale të pastrimit të parave, veçanërisht persona të tretë profesionistë dhe/ose subjekte raportuese (gatekeeper), ashtu dhe për rritjen më tej të hetimeve financiare e pasurore për identifikimin, sekuestrimin dhe/ose konfiskimin e pasurive produkte të veprimtarisë kriminale, ose vlerën ekuivalente, bazuar në prova/rrethana fakti objektive sipas ligjit, etj.

Neni 5

Masat administrative në prokuroritë e juridikzionit të përgjithshëm¹⁰

1. Drejtuesit e prokurorive të juridikzionit të përgjithshëm, brenda 5 ditëve nga mbërritja/regjistrimi i rekomandimeve prioritare, ua shpërndajnë për njohje dhe vlerësim prokurorëve dhe organizojnë mbledhjen e tyre për diskutimin dhe dhënien e mendimit lidhur me masat, aktivitetet dhe/ose për mënyrën e zbatimit tyre.

2. Drejtuesit e prokurorive, jo më vonë se 10 ditë nga mbledhja e prokurorëve, bazuar dhe në mendimet e tyre, vlerësojnë nevojat përmarrjen e masave administrative dhe procedurale, dhe në zbatim të kompetencave të parashikuara në ligj¹¹ miratojnë një udhëzim të përgjithshëm për të lehtësuar zbatimin e këtij udhëzimi, dhe një plan veprimi në kuadrin e Planit të Veprimit të miratuar nga Prokurori Përgjithshëm, ku parashikojnë masat e nevojshme në përputhje me specifikat dhe gjendjen e prokurorisë që drejtojnë, përfshi nevojat për buxhet (nëse është i nevojshëm), për të siguruar zbatimin e rekomandimeve prioritare, duke respektuar pavarësinë e institucionit dhe garantuar pavarësinë e prokurorëve.

3. Plani i veprimit, krahas masave dhe aktiviteteve konkrete, përmban edhe tregues statistikorë (indikatorë) që do të plotësohen për të vlerësuar zbatimin e rekomandimeve

¹⁰ Shih, nenin 2 shkronja “d” e ligjit nr.97/2016;

¹¹ Shih, po aty, nenet 42, 45 pika 1, 46 pikat 1, 3 shkronja ”c” e vijues të ligjit nr.97/2016;

prioritare, udhëzimeve të përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm të nxjerrë në vijim të tyre, dhe udhëzimeve të përgjithshme të nxjerrë nga vetë drejtuesi i prokurorisë.

4. Në vijim drejtuesit e prokurorisë, udhëzimin e përgjithshëm dhe planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve prioritare, pa vonesë, ua njoftojnë gjithë prokurorëve, oficerëve të policisë gjyqësore të seksionit dhe strukturave hetimore në shërbimet përkatëse të Policisë Gjyqësore, një kopje e dërgojnë në Prokurorinë e Përgjithshme, si dhe marrin masa e nevojshme organizative në drejtim të riorganizimit të brendshëm, për koordinimin dhe forcimin e kapaciteteve institucionale e profesionale prioritare të rekomanduara, dhe ndjekin/mbikëqyrin në vazhdimësi ecurinë e zbatimit të tyre.

5. Drejtuesit e prokurorive, informojnë Prokurorinë e Përgjithshme (Drejtorinë e Koordinimit Institucional ose strukturën përkatëse), në mënyrë periodike çdo tre muaj, dhe sa herë kërkohet¹², për ecurinë e masave administrative e procedurale, angazhimet dhe progresin e arritur në zbatim të secilit prioritet të rekomanduar, të shoqëruara me tregues/indikator statistikorë të saktë e analistik dhe me shpjegime të qarta mbi angazhimet, arrijet dhe problematikat, dhe si ka ndikuar zbatimi i tyre mbi gjendjen e kriminalitetit në prioritetet e rekomanduara.

6. Në raportin vjetor të punës së prokurorisë, drejtuesit e prokurorive, gjithashtu, analizojnë në mënyrë të detajuar zbatimin e rekomandimeve prioritare në prokurorinë që drejtojnë, lidhur me arrijet, problematikat dhe si ka ndikuar zbatimi i tyre mbi gjendjen e kriminalitetit në fushat/drejtimet e rekomanduara.

KREU III MASAT PROCEDURALE

Neni 6

Masat procedurale të drejtuesit të prokurorisë

1. Drejtuesit e prokurorive, në zbatim të kompetencave të parashikuara në ligj¹³ vlerësojnë rekomandimet prioritare dhe nevojat për marjen e masave procedurale në kryerjen e hetimeve dhe ushtrimin e ndjekjes penale në përshtatje me gjendjen e treguesve të kriminalitetit dhe problematikat e evidentuara në rrethin/et gjyqësore¹⁴ që mbulon prokuroria që drejtojnë, si dhe për të lehtësuar¹⁵ dhe garantuar¹⁶ zbatimin e udhëzimeve të përgjithshme të Prokurorit të

¹² Shih, nenet 50 pika 1 e 103 pika 5 të ligjit nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në R.Sh”, në lidhje me nenin 6, paragrafi 32 i ligjit nr.8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë” i ndryshuar, që parashikon: “... Ministri i Drejtësisë ndjek në vazhdimësi mënyrën e zbatimit të rekomandimeve të dhëna prej Këshillit të Ministrave. Për këtë qëllim, Ministri i Drejtësisë kërkon jo më pak se dy herë në vit pranë Prokurorit të Përgjithshëm dhe Drejtuesit të Prokurorisë së Posaqme informacion mbi zbatimin e tyre...” dhe nenin 50 pika 1 e ligjit nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në R.Sh”

¹³ Shih, nenet 42, 43, 46 pikat 1, 3 shkronja “c”, 48, 49, 52 e vijues të ligjit nr.97/2016 .

¹⁴ Rrethi gjyqësor në kompetencë tokësore të gjykatës së shkallës së parë e juridiksonit të përgjithshëm pranë të cilës ushtron funksionet prokuroria e rrethit gjyqësor, dhe rrethet gjyqësore në kompetencë tokësore të gjykatës së apelit me juridikson të përgjithshëm pranë të cilës ushtron funksionet prokuroria e apelit.

¹⁵ Shih, nenin 46 pikat 4 e ligjit nr.97/2016, që parashikon: “4. Drejtuesit e prokurorive mund të nxjerrin udhëzime të përgjithshme për çështje të organizimit dhe funksionimit të prokurorisë që drejtojnë dhe për të lehtësuar zbatimin e udhëzimeve të përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm...”.

Përgjithshëm lidhur me masat procedurale, duke respektuar pavarësinë e institucionit dhe garantuar pavarësinë e prokurorëve, marrin masat si më poshtë:

- a) nxjerrin udhëzime të përgjithshme që sigurojnë zbatimin e rekomandimeve prioritare dhe garantojnë e lehtësojnë zbatimin e udhëzimeve të përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm;
- b) nxjerrin udhëzime jo të detyrueshme për çështje konkrete, në momentin e caktimit të çështjes për ndjekje, përfshi rastet e regjistruara/filluara kryesisht, ose kur vlerësohet e nevojshme për mbarëvajtjen e ecurisë së procedimit, për veprat penale sipas kompetencës lëndore dhe në drejtimet prioritare të rekomanduara;
- c) koordinojnë veprimtarinë me prokuroritë e tjera për çështje konkrete që lidhen me fushat/drejtimet prioritare të rekomanduara;
- ç) kërkojnë informacion dhe verifikojnë ecurinë/përfundimin e procedimeve për veprat penale prioritare të rekomanduara sipas ligjit dhe në kuadrin e forcimit të mekanizmit të kontrollit dhe llogaridhënieς, duke garantuar paanshmërinë dhe shmangien e çdo lloj influence apo ndikimi ndaj prokurorit gjatë kryerjes së hetimeve në drejtimet prioritare të rekomanduara;
- d) organizojnë marrjen e masave të nevojshme administrative, dhe kërkojnë nga prokurorët që në koordinim me zyrën/nëpunësin e regjistrat tē pasqyrohen, pa vonësë, në regjistrat përkatës sipas fazave të procedimit të dhënat për ecurinë e procedimit/çështjes, dhe mbikëqyrin/kontrollojnë në vazhdimi saktësinë e të dhënavë tē regjistruara, administruara, dhe të dhënat statistikore të dërgohen në afat në Prokurorinë e Përgjithshme, dhe jo vetëm, me synim përmirësimin e koordinimit institucional në lidhje me raportimin e të dhënavë statistikore, që lidhen me progresin e integrimit të vendit në drejtimet prioritare të rekomanduara.

2. Drejtuesit e prokurorive, gjithashtu, në kuadrin e masave që sigurojnë zbatimin e rekomandimeve prioritare, udhëzohen:

- a) të jenë aktiv në fillimin kryesisht të procedimeve/hetimeve, verifikimin e ecurisë dhe përfundimin e çështjeve për veprat penale prioritare të rekomanduara, duke monitoruar në veçanti, afatet procedurale, rritjen e efektivitetit dhe plotshmërisë së hetimeve, si dhe respektimin e të drejtave të subjekteve të procedimit penal dhe garantimin e procesit të rregullt ligjor;
- b) të zhvillojnë mbledhje tematike me prokurorët e seksioneve, prokurorët e caktuar për ndjekjen e çështjeve apo me oficerët e policisë gjyqësore tē seksioneve apo tē strukturave hetimore në shërbimet e Policisë së Gjyqësore tē caktuar për ecurin në kryerjen e hetimeve për veprat penale prioritare të rekomanduara;
- c) të nxjerrin urdhra për policinë gjyqësore që kanë në juridikcion lidhur me ushtrimin e funksioneve në kuadër të luftës kundër veprave penale prioritare të rekomanduara;
- ç) të mbështesin punën e prokurorëve në ushtrimin e funksioneve nëpërmjet menaxhimit të duhur të burimeve njerëzore dhe logjistike në dispozicion, si dhe për krijimin e ambienteve të përshtatshme në prokurori në zbatim tē Kodit të Drejtësisë Penale për tē Mitur për tē siguruar aksesin për persona me paaftësi fizike dhe pritjen e publikut, sipas prioriteteve të rekomanduara;
- d) të koordinojnë me eficencë veprimtarinë me prokuroritë e tjera kur kjo kërkohet në drejtimet/fushat ose për veprat penale prioritare të rekomanduara;

¹⁶ Shih, po aty, nenin 43 shkronja “dh” e ligjit nr.97/2016, që parashikon: “4. Drejtuesi i prokurorisë ka këto kompetenca në ushtrimin e ndjekjes penale: dh) garanton zbatimin korrekt të udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm”.

dh) të bashkëpunojnë në mënyrë efektive me institucionet shtetërore dhe ato ligjzbatuese me rol të posaçëm në luftën kundër veprave penale prioritare të rekomanduara, si dhe të organizojnë dhe zhvillojnë analiza të përbashkëta ndërinstitucionale sipas nevojave dhe jo më pak se çdo gjashtë muaj;

e) të koordinojnë dhe organizojnë trajnime të përbashkëta me agjencitë e zbatimit të ligjit të përfshira në luftën kundër veprave penale prioritare të rekomanduara, si dhe të lehtësojnë pjesëmarrjen e prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore në trajnime të përbashkëta me agjencitë e tjera të zbatimit të ligjit në fushat dhe drejtimet e rekomanduara, veçanërisht në ato me fokus në luftën kundër korruptionit, krimet e rënda dhe/ose trafikimet e paligjshme, veprat me bazë gjinore, seksuale dhe/ose me përfshirjen e të miturve, si dhe me focus bazushmeria në ligj e hetimeve dhe vlefshmëria e provave në hetimet financiare, evazionit fiskal dhe krimeve kibernetike.

Neni 7
Masat proceduriale të prokurorit

1. Prokurorët, vlerësojnë në çdo rast masat në rekomandimet prioritare për luftën ndaj kriminalitetit në kompetencë lëndore të tyre dhe udhëzimet e përgjithshme dhe/ose udhëzimet e nxjerra nga drejtuesi i prokurorisë për të garantuar zbatimin e tyre, që ndihmojnë dhe/ose lehtësojnë në rritjen e eficencës dhe efektivitetit në luftën kundër kriminalitetit sipas prioriteteve të rekomanduara, dhe duke ruajtur pavarësinë nga çdo ndikim të paligjshëm në vendimarrjen e tyre, marrin masat procedurale të udhëzuara, si më poshtë:

a) të jenë aktiv gjatë hetimeve paraprake sipas ligjit¹⁷, në funksion të shtimit të rasteve të hetimeve të filluara kryesisht për veprat penale prioritare të rekomanduara;

b) kryejnë hetime të plota e të gjithanshme për veprat penale dhe/ose ndaj subjekteve për veprat penale prioritare të rekomanduara, sipas kompetencës lëndore, në bashkërendim me Prokurorinë e Posaçme sipas ligjit dhe aktit të kordinimin ndërinstitucional¹⁸, duke rritur më tej treguesit/rastet e hetime proaktive efektive, përdorimin e metodave speciale të hetimit sipas ligjit, dhe hetimet financiare ose procedimet pasurore (*ndiq paranë*), si mjete për kërkimin e provave dhe për sekuestrimin/konfiskimin e pasurive/aseteve produkte të veprave penale ose veprimtarive kriminale prioritare të rekomanduara.

c) vlerësojnë dhe konsiderojnë ekzistencën e kushteve/kritereve ligjore për lidhjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit në zbatim të nenit 37/a të Kodit të Procedurës Penale, duke synuar vënien përpara përgjegjësisë të çdo bashkëpunëtori në veprimtarinë kriminale, me synim për të parandaluar dhe riparuar dëmet e shkaktuara për veprat penale prioritare të rekomanduara;

¹⁷ Shih, nenin 24 "Funksionet e prokurorit" të K.Pr.Penale, i cili në pikën 6 parashikon: "6. Kur nuk është i nevojshmëri ankimi i viktimit, ndjekja penale ushtrohet kryesisht", në lidhje me nenin 5 "Detyrueshmëria e ushtrimit të ndjekjes penale" të ligjit nr.97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në R.SH", i cili parashikon:"Ushtrimi i ndjekjes penale është i detyrueshëm, me përashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe".

¹⁸ Shih, Aktin e Koordinimit Ndërinstitucional, datë 15 dhjetor 2020, mes Prokurorit të Përgjithshëm dhe Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme.

ç) përdorin me efikasitet bazat e të dhënave të institucioneve ligjzbatuese të tjera ku prokuroria ka akses për rritjen e efektivitetit të hetimeve;

d) kryejnë analiza të përbashkëta me oficerët e policisë gjyqësore të seksioneve dhe të shërbimeve policore në strukturat hetimore përkatëse dhe/ose të agjensive ligjzbatuese, për rastet e referuara, shkëmbimin dhe kërkimin e ekspertizës në funksion të përmirësimit të shpejtësisë e gjithanshmërisë në securinë e hetimeve të specializuara ndaj subjekteve përkatës për veprat penale prioritare të rekomanduara;

dh) tregojnë kujdes të shtuar në ruajtjen e sekretit të hetimit dhe ndalimin e publikimit të akteve, duke konsideruar veçanërisht mundësinë e përfshirjes së punonjësve shtetërorë si bashkëpunëtorëve të "jashtëm ose brendshëm" në luftën kundër kimeve të rënda, korruptionit dhe veprave të tjera prioritare të rekomanduara;

de) sigurojnë zbatimin e udhëzimeve të përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm sipas fushave/drejtimeve prioritare të rekomanduara dhe akteve/marrëveshjeve të përbashkëta ndërinstitucionale të rekomanduara që unifikojnë dhe lehtësojnë koordinimin dhe bashkërendimin me strukturat/institucionet në fushat përkatëse të rekomanduara;

ë) sigurojnë zbatimin efektiv të të drejtave procedurale, si të pandehurve, personave nën hetim apo të dyshuarve, ashtu dhe të viktimave dhe garantojnë procesin e rregullt ligor ndaj subjekteve të veprave penale prioritare të rekomanduara;

f) ndjekin një politikë penale efektive dhe eficiente, me synim rritjen e efektivitetit në luftën kundër kimeve prioritare të rekomanduara, ashtu dhe për parandalimin e posaçëm dhe të përgjithshëm të veprave penale prioritare të rekomanduara, veçanërisht, duke analizuar, vlerësuar dhe arsyetuar në aktet/kërkeshat/konkluzionet procedurale, si rrëthanat e faktit të bazuara në prova, ashtu dhe kushtet/kriteret ligjore për:

i) ashpërsimin e kërkeshave për caktimin e masave të sigurimit personal dhe për caktimin e llojit dhe masës së dënimit për veprat penale kultivimi i narkotikve, dhuna në familje, dhuna gjinore, krimet seksuale dhe/ose vepra penale të tjera të rekomanduara;

ii) vijimin e aplikimit të masave alternative të shhangjës ndaj të miturve në konflikt me ligjin sipas rekomandimeve prioritare;

iii) zbutjen e dënimit apo aplikimin e dënimive alternative në rastet e veprave penale dhe/ose autorëve me rrezikshmëri të ulët shoqërore, personave vulnerabël ose personave me problem serioze shëndetësore sipas rekomandimeve prioritare;

g) vijimin në rritjen e numrit të kërkeshave për gjykim të drejtpërdrejtë dhe për rritjen e numrit të kërkeshave në zbatimin e instituteve procedurale penale të gjykit me marrëveshje dhe urdhrit penal, duke vlerësuar kushtet dhe kriteret ligjore dhe synimet prioritare të rekomanduara.

gj) rritjen dhe zhvillimin e kapaciteteve dhe aftësive profesionale të tyre, nëpërmjet pjesëmarries në trajnime apo në tryesa diskutimesh, veçanërisht për zbatimin e dispozitave të reja të Kodit Penal, si dhe trajnime të përbashkëta me oficerët e policisë gjyqësore të seksioneve dhe të strukturave hetimore në shërbimet, me fokus në fushat dhe drejtimet prioritare të rekomanduara, me fokus në luftën kundër korruptionit, krimet e rënda dhe kundër trafikimeve, veprat me bazë gjinore, seksuale dhe me përfshirjen e të miturve, si dhe lishmëria e hetimeve dhe vlera e provave në hetimet financiare, evazionin fiskal dhe krimet kibernetike.

Neni 8

Masat në marrëdhënie me policinë gjyqësore

1. Prokurori vlerëson në çdo rast zbatimin e parimit të specializimit dhe urdhëron për kryerjen e hetimeve paraprake oficerët e policisë gjyqësore të strukturës hetimore përkatëse që ka referuar veprën penale në prokurori.

2. Në raste të veçanta, me kërkesë të arsyetuar të prokurorit për të garantuar objektivitetin e hetimit, drejtuesi i prokurorisë mund të urdhërojë për kryerjen e hetimeve oficerët e policisë gjyqësore të strukturave hetimore përkatëse të shërbimeve të tjera ose të seksioneve të policisë gjyqësore në prokurorinë që drejton.

3. Referuar natyrës dhe kompleksitetit të çështjes për vepra penale prioritare të rekomanduara, shtimin e rasteve të urdhëruara nga prokurori dhe/ose drejtuesi i prokurorisë për kryerjen e veprimeve hetimore të përbashkëta nga oficerë të policisë gjyqësore në strukturat hetimore të shërbimeve me ato të seksioneve në prokurori, sipas prioriteteve të rekomanduara.

4. Prokurorët ushtrojnë sistematikisht kontroll efektiv OPGj-ve në ecurinë e hetimit të procedimeve në ndjekje për ligjshmérinë, objektivitetin, plotshmérinë dhe respektimin e afateve në veprimet hetimore të kryera dhe/ose vlefshmérinë e akteve procedurale të përfshitura, në drejtimet prioritare të rekomanduara.

5. Drejtuesi i prokurorisë, i cili drejton, bashkërendon dhe mbikëqyr veprimtarinë e policisë gjyqësore në juridikcionin e prokurorisë që drejton dhe/ose prokurori i çështjes konkrete, në rast evidentimi të akteve dhe sjelljeve që përbëjnë shkelje disiplinore sipas ligjit¹⁹, përkatësisht kërkojnë dhe iniciojnë fillimin e procedimit disiplinor sipas ligjit²⁰.

KREU IV

PËRGJEGJËSIA DISIPLINORE, ZBATIMI, SHFUQIZIME, HYRJA NË FUQI DHE PUBLIKIMI

Neni 9

Shkeljet dhe përgjegjësia disiplinore

Shkelja e dispozitave ligjore referuese në këtë udhëzim të përgjithshëm dhe/ose mosbatimi i detyrimeve të përcaktuara në këtë udhëzim, mund të përbëjnë, shkelje disiplinore sipas ligjit²¹ dhe/ose shkak për nisjen e verifikimeve nga sektori i monitorimit në Prokurorinë e Përgjithshme ndaj oficerit të policisë gjyqësore, prokurorit dhe/ose drejtuesit në prokuroritë me juridikcion të përgjithshëm, sipas ligjit.

¹⁹ Shih, nenin 33 "Shkeljet disiplinore" të ligjit nr.25/2019 "Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore", i ndryshuar.

²⁰ Shih, po aty, nenin 35 "Subjektet që kanë të drejtën e fillimit të procedimit disiplinor" të ligjit nr.25/2019.

²¹ Shih, nenin 101 pika 1 shkronja "a", "b" dhe nenin 102 pika 1 shkronjat "ç", "d", "dh", "ë", "g" "j", "l" "ll", "nj" dhe pika 2 shkronjat "a", "b", "c", "ç", "d" "dh" e vijues të ligjit nr.96/2016 i ndryshuar me ligjin nr. 48/2019.

Neni 10
Zbatimi dhe mbikëqyrja

1. Ky udhëzim i përgjithshëm është i detyrueshëm për zbatim nga prokurorët, drejtuesit e prokurorive dhe oficerët e policisë gjyqësore në strukturat hetimore të shërbimeve dhe të seksioneve në prokuroritë e juridikzionit të përgjithshëm²², si dhe.

2. Me mbikëqyrjen e zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen drejtuesit e prokurorive²³ dhe Drejtoria e Koordinimit Institucional në Prokurorinë e Përgjithshme, të cilët për ecurinë e zbatimit të këtij udhëzimi dhe rekomandimeve prioritare informojnë periodikisht Prokurorin e Përgjithshëm.

3. Drejtuesit e prokurorive mund të nxjerrin udhëzime të përgjithshme për lehtësimin e zbatimit të këtij udhëzimi të përgjithshëm²⁴.

Neni 11
Shfuqizime

Udhëzimi i përgjithshëm nr.4/2021 “Për rekondimet prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2021 në prokuroritë e juridikzionit të përgjithshëm”, shfuqizohet.

Neni 12
Hyrja në fuqi dhe publikimi

Ky udhëzim i përgjithshëm hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen e internetit të Prokurorisë së Përgjithshme.

PROKUROR I PËRGJITHSHËM



²² Shih nenin 46 pika 1 dhe nenin 103 të ligjit nr.97/2016

²³ Shih po aty nenin 43 shkronja “dh”.

²⁴ Shih po aty nenet 46 pika 4.